

PRIORITETET KRYESORE NË FUSHËN E ÇËSHTJEVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2026



Ndërtimi i një sistemi modern të sigurisë dhe administrimit të brendshëm, të mbështetur në transformimin digjital, forcimin e sundimit të ligjit, përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

SHTYLLAT STRATEGJIKE 2026



Siguri Publike dhe Luftë kundër Krimit



Transformim Digjital dhe projekti “Smart City”

EU

Integrim European dhe Schengen



Identitet Digjital dhe Shërbime Moderne



Menaxhim Kufitar dhe Migracion



Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjenca Civile



Kontrolli i Territorit dhe Forcimi i Institucioneve

1. IMPLEMENTIMI I LIGJIT TË RI TË POLICISË SË SHTETIT DHE MODERNIZIMI I SHËRBIMIT POLICOR

1-1 Përfundimi i akteve nënligjore, që burojnë nga ligji i ri i Policisë së Shtetit.

1-2 Miratimi dhe zbatimi i strukturës së re organizative të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të varësisë.

1-3 Rritja e efikasitetit operacional dhe profesionalizimit të shërbimit policor në përputhje me standardet e BE-së.

2. FORCIMI I LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, KORRUPSIONIT, PASTRIMIT TË PARAVE DHE KRIMIT KIBERNETIK

2-1 Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030.

2-2 Rritja e hetimeve proaktive, operacioneve policore dhe sekuestrimit të aseteve kriminale.

2-3 Forcimi i kapaciteteve për hetimin e krimit kibernetik dhe mbrojtjen e infrastrukturave kritike digjitale.

3. RRITJA E SIGURISË PUBLIKE NËPËRMJET TEKNOLOGJISË DHE PROJEKTIT “SMART CITY”

3-1 Implementimi i teknologjive inteligjente për monitorimin e sigurisë publike dhe kontrollin e territorit.

3-2 Përmirësimi i sigurisë rrugore përmes sistemeve automatike të monitorimit dhe analizës së të dhënave.

3-3 Integrimi i sistemeve teknologjike për menaxhimin e incidenteve dhe reagimin e shpejtë ndaj emergjencave.

4. PËRMBUSHJA E STANDARDEVE SCHENGEN DHE MODERNIZIMI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT

4-1 Zbatimi i Planit të Veprimit Schengen dhe masave të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.

4-2 Modernizimi i kontrollit kufitar përmes sistemeve E-Gate dhe teknologjive të avancuara.

4-3 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për sigurinë kufitare dhe menaxhimin e migracionit.

5. MENAXHIMI I MIGRACIONIT DHE MBROJTJA E GRUPEVE VULNERABËL

5-1 Përmirësimi i procedurave për hyrjen, qëndrimin dhe integrimin e të huajve në Shqipëri.

5-2 Ngritja e mekanizmave të mbrojtjes për fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë.

5-3 Rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e flukseve migratore sipas standardeve evropiane.

6. PARANDALIMI I TERRORIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

6-1 Hartimi i Vlerësimit Kombëtar të Riskut për Terrorizëm.

6-2 Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2026–2031.

6-3 Forcimi i bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal në luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

7. DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE TË GJENDJES CIVILE DHE IDENTITETIT DIGJITAL

7-1 Finalizimi i modernizimit të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe sistemit të adresave.

7-2 Zhvillimi dhe implementimi i identitetit digjital për shtetasit shqiptarë.

7-3 Rritja e numrit të shërbimeve elektronike dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në platformën e-Albania.

8. SIGURIA DHE NJOHJA NDËRKOMBËTARE E DOKUMENTEVE TË IDENTITETIT

8-1 Modernizimi i infrastrukturës së identifikimit elektronik dhe dokumenteve biometrike.

8-2 Përgatitja e ndryshimeve ligjore për dokumentet biometrike shqiptare.

8-3 Konsolidimi i standardeve të sigurisë dhe besueshmërisë së identitetit elektronik.

9. FORCIMI I KONTROLLIT TË TERRITORIT DHE LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT

9-1 Riorganizimi dhe forcimi i kapaciteteve të IKMT-së.

9-2 Konsolidimi i Policisë Bashkiake dhe rolit të saj në monitorimin e territorit.

9-3 Përdorimi i teknologjisë dhe platformave digjitale për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve në territor.

10. FORCIMI I INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT

10-1 Miratimi i ndryshimeve ligjore për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit.

10-2 Rritja e rolit koordinues në monitorimin e territorit dhe zbatimin e ligjit.

10-3 Përmirësimi i bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe institucionet e sigurisë.

11. MODERNIZIMI I SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

11-1 Përditësimi i kuadrit ligjor për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

11-2 Përmirësimi i kapaciteteve teknike, logjistike dhe profesionale të shërbimit zjarrfikës.
